Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet ti kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të

paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në

përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.
4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** ____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë** (në rast BOE): _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*]

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit**Nënshkrimi****Vula**

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Objekti: “Prodhim i ortofotove nga fotografitë ajrore historike”

1 INFORMACION I PËRGJITHSHËM I PUNËS

1.1 PËRMBLEDHJE

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), bazuar në ligjin nr.72/2012, datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, është institucioni përgjegjës për krijimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë.

Në përmbushje të detyrave të tij, ASIG po menaxhon një projekt që lidhet me krijimin e ortofotove nga fotografitë ajrore historike të kryera në vite, për territorin e Republikës së Shqipërisë. Implementimi i këtij projekti është në përputhje me aktivitetin kryesor të ASIG si përgjegjës për temën “Ortoimazheria” dhe për ndërveprueshmërinë institucionale.

ASIG ka kryer me mbështetjen e Qeverisë Norvegjeze procesin e inventarizimit dhe skanimit e fotografive ajrore historike që ndodhen në arkivat e IGJIU-së dhe ka rezultuar të jenë rreth 25397 fotografi ajrore të printuara në letër (*hardcopy*) dhe në film (*celluloid*).

Më poshtë po japim një informacion më të detajuar të nxjerra nga inventarizimi i kryer:

1. Fotografim Rus, viti 1957, shkalla 1:25000, dimensionet e fotografive 18cm x 18cm
2. Fotografim Rus, viti 1957, shkalla 1:25000, dimensionet e fotografive 30cm x 30cm
3. Fotografim i ITU, shkalla 1:13000, dimensionet e fotografive 18cm x 18cm, Qytete
4. Fotografim i ITU, shkalla 1:25 000, dimensionet e fotografive 18cm x 18cm
5. Fotografim i ITU, shkalla 1:10 000, dimensionet e fotografive 18cm x 18cm

Krijimi i ortofotos nga fotografitë ajrore historike konsiderohet informacion i rëndësishëm për shumë institucione të cilat janë veçanërisht të interesuara për regjistrimin kronologjik të ndryshimeve të përdorimit të tokës dhe zhvillimit të situatës demografike në Shqipëri.

Qëllimi i përgjithshëm i aktivitetit është të sigurojë një qasje të përmirësuar të publikut në informacionin gjeografik, duke e publikuar si shërbim në Gjeoportalin Kombëtar. Ky shërbim i Gjeoportalit Kombëtar do të jetë një ndihmesë për të gjitha institucionet që merren me trajtimin e pronës si ASHK (Agjensia Shtetërore e Kadastrës), pushtetit vendor dhe ATP (Agjensia e Trajtimit të Pronave), Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe shumë autoriteteve të tjera që veprimtarinë e tyre e kanë lidhur me këtë lloj informacioni.

1.2 QËLLIMI I DOKUMENTIT

Ky dokument është pjesë e njoftimit për tender për prokurimin sipas "procedurës së hapur" për dhënien e një kontrate publike **“Krijimi i ortofotos nga fotografitë ajrore historike”**, për fotografimin e Institutit Topografik Ushtrise (ITU) përdorur për pordhimin e hartave topografike në shkallë 1:25 000.

Qëllimi i këtij dokumenti është që ti ofrojë ofertuesit informacion të detajuar mbi subjektin e prokurimit, kërkesat dhe specifikimet.

1.1 BAZA LIGJORE

Në bazë të nenit 11, pika 1, të ligjit nr.72/2012 datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë”, të dhënat gjeohapësinore krijohen, mbledhen, përditësohen dhe vihen në dispozicion të publikut, në përputhje me rregullat dhe afatet e përcaktuara nga ky ligj dhe nga aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, sipas klasifikimit dhe përkatësisë së tyre në temat e veçanta.

Në bazë të nenit 11, pika 2/i, të ligjit nr.72/2012 datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë”, temat e të dhënave gjeohapësinore përfshijnë: Ortoimazherinë.

Në bazë të nenit 12, pika 1 dhe 2, të ligjit nr.72/2012 datë 28.06.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të të dhënave gjeohapësinore në Republikën e Shqipërisë”:

1. Mbledhja, përpunimi dhe përditësimi i të dhënave gjeohapësinore për secilën ngatemat e përcaktuara nga neni 11 i këtij ligji, kryhen në përputhje me vendimet e ASIG-ut për secilën temë.
2. Në vendimin e ASIG-ut për secilën temë identifikohen autoritetet publike përgjegjëse për mbledhjen, përpunimin dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore përkatëse, si dhe përcaktohen afatet për mbledhjen e të dhënave dhe depozitimin e tyre pranë këtij autoriteti.
3. Bazuar në Vendimin e ASIG Nr.20 datë 07.11.2016, ASIG është autoriteti përgjigjës për temën e Ortoimazherisë.

1.2 ZONA E PROJEKTIT

Zona e projektit ndahet sipas të dhënave të mëposhtme të llogaritura sipas mbulesës së fotografive sipas Aneksit 1:

Nr	Produkti	Numri i fotografive ajrore të skanuara /copë	Nr, Kuti ve (blloqet)	Shk. e fotografi mit	Shk. e hartave të prodhuara	Viti i fotografimi	Madhësia e imazhit të skanuar/ cm
1	Fotografi ajrore Institutit Topografik Ushtrise (ITU)	7287	81	1:33000	1:25000	1970 deri 1986	18 x 18

Shiko Aneksi 1,

Itineraret fotografitë ajrore historike

TË DHËNAT TEKNIKE TË SKANIMIT TË FOTOGRAFIVE AJRORE HISTORIKE

- Fotografimi ajror është kryer, me film monokromatik dhe shkalla e fotove ajrore është 1:33000.
- Madhesia e fotografive origjinale është 18x18 cm
- Fotot e ajrore janë monokromatike (bardhë e zi).
- Fotot ajrore kanë mbulim gjatësor prej 60% dhe mbulim tërthor prej 30%
- Ne folderin dixhital janë evidentuar 7287 fotografi ajrore të organizuara në 81 nënfoldera.
- Fotot ajrore janë skanuar me rezolucion 600 dpi, duke përdorur një skaner desktop.
- Pozicioni gjeografik i fotove digjitale është bërë nëpërmjet pozicionimit në hartën të qendrës së fotove ajrore. Të dhënat rreth itinerareve dhe fotove ajrore janë në formatin shape-file.

1.3 REFERENCA GJEODEZIKE

Sistemi i References Koordinative dhe Projeksioni Hartografik

Ortofoto do të prodhohet dhe lëvrohet me Sistemin e References Gjeodezike (Plan dhe Lartësi) bazuar në përcaktimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 669, më 07/08/2013 (KRGJSH), të ndryshuar.

2 PËRMBLEDHJA E DORËZIMEVE

Ofertuesi kërkohet që të:

Ref.	Kerkesa	Përgjigje Ofertuesit
2.1	Të kryej aerofototriangulacionin dhe të japë të dhënat për imazhet dixhitale të orientuara për zonën e projektit, sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në këtë dokument.	
2.2	Të prodhojë Ortofoto në formatin monokromatik (bardhë e zi) për zonën e mbuluar nga imazhet e skanuara të fotografimit ajrore historike nga Instituti Topografik i Ushtrisë (ITU) për prodhimin e hartave topografike të shk.1:25000, për vitet 1970–1986, sipas specifikimeve teknike të këtij dokumenti.	
2.3	Të dorëzojë Ortofoton në formatet TIF dhe JPEG në 2 (dy) kopje dixhitale - Hard Disk.	

2.4	Të dorëzojë raportin përfundimtar të prodhimit të ortofotos.	
-----	--	--

2.1 RAPORTIMI

Kontraktuesi do të sigurojë dorëzimin e raportit përfundimtar në momentin e dorëzimit të produktit. Raporti duhet të përmbajë të gjithë ecurinë e punëve të realizuara:

- Raportin e Aerofototriangulacionit për orientimin e imazheve ajrore të fotografimit ajror. Në këtë fazë të raportit do të identifikohen dhe fototrafite ajrore të cilat për arsye të skanimit jo korrekt nuk do të përdoren në proceset e mëtejshme.
- Raportin e Prodhimit të Ortofotos me anë të fotografive ajrore të skanuara të fotografimit ajror.
- Raportin e kontrollit të cilësisë dhe saktësisë së prodhimit të ortofotos.

2.2 PERIUDHA E EKZEKUTIMIT

Periudha e ekzekutimit të projektit do të jetë 75 ditë nga data e nënshkrimit të kontratës.

3 SPECIFIKIMET DHE KËRKESAT TEKNIKE

3.1 DETYRIMET E ASIG

ASIG është përgjegjës për dhënien e të dhënave orientuese, Kontraktorit (WMS e Ortofoto ekzistuese dhe DTM ekzistues)

3.2 ORIENTIMI I IMAZHEVE TË SKANUARA

Prodhimi i Imazheve ajrore të orientuara përbëhet nga fotografi ajrore dhe Aerofototriangulacioni. Qëllimi i këtij specifikimi është për të siguruar cilësi të mjaftueshme të prodhimit të ortofotos. Dorëzimet për këtë proces pune janë të përshkruara në tabelën e mëposhtme:

Produkti		Dokumentacioni
Të dhënat	Metadata	
- Projektet e blloqeve të adjustimit të Aerofototriangulacionit AT (file dixhitale) - Pikat e Kontrollit të dokumentuara në format shapefile, në fund të detajuara më tej me skica dhe në format shapefile tekst përshkrues në format PDF.	- Metadata sipas standartit të miratuar.	- <i>Raporti i Aerofototriangulacionit për orientimin e imazheve ajrore të fotografimit ajror të qyteteve</i>

Përmbajtja dhe struktura e raporteve duhet të jetë në përputhje me atë që është paraqitur në Produktin e Planit të cilësisë nga kontraktori dhe të reflektojë analizat e kryera.

Në vijim, do të përshkruhet në raportin përfundimtarë:

- Harduare dhe programet e përdorura
- Rezultatet e përpunimit, duke përfshirë përshkrimin e metodës.
- Dokumentimi i Kontrollit të Raportit të cilësisë të përputhet me specifikimet e dhëna teknike.

Raporti i Aerofototriangulacionit për orientimin e imazheve ajrore të fotografimit ajror duhet të përmbajë një Indeks të Fluturimit me linjat e fluturimit, numrat e linjave, qendrat e fotove (të planifikuara dhe aktuale), numrat e fotove dhe detajet e terrenit (PDF / format SHP). Përveç kësaj duhet të ketë një tabelë që tregon devijimin mes qendrave të planifikuara dhe aktuale të fotove.

4.2 PIKAT E KONTROLLIT

Ofertuesi do të krijojë një numër GCP që do të përdoren në fazën e aerofototriangulacionit.

Burimet e mundshme të pavaruara për të pozicionuar pikat e kontrollit janë:

- Përdorimi i Ortoimazherive me rezolucion dhe saktësi më të lartë. Këto të dhëna dhe mund të përdoren nga Gjeoportali Kombetar (<https://geoportal.asig.gov.al/>).
- Kriter duhet të jetë identifikimi i kontureve të saktë konture të njëjtë në imazhet e fotografive ajrore me terrenin.

Planifikimi i numrit dhe mbulimit me GCP-ve të zonës së mbuluar me fotografitë ajrore të skanuara të qyteteve:

- GCPs duhet të shpërndahen përgjatë perimetrit të bllokut të paktën çdo 30 km dhe pika të shpërndara brenda bllokut

- Duhet të ketë minimumi 1 (një) pikë për 30 km² në këto zona.

4.3 SPECIFIKIMET DHE KËRKESAT E CILËSISË PËR ORTOFOTON

Ortofoto duhet të prodhohet në të gjithë zonën e projektit.

Ref.	Kerkesat
5.1	Të dhënat hartografike si Ortoimazheri dhe DTM ekzistuese, do të përdoren për krijimin e Ortofotos.
5.2	-Ortofoto me një madhësi pikseli prej 1.50 m duhet të prodhohet për Zonën sipas aneksit 1 të mbuluar nga imazhet e skanuara të fotografimit ajror historik për dorëzuar për prodhimin e H.Topografike 1:2500. Periudha e fotografive varjon nga vitet 1970- 1986.
5.3	Linjat bashkimit ndërmjet imazheve për krijimin e ortofotos, duhet të jetë minimalisht të dukshme. Linjat bashkimit duhet të dorëzohen si shape, Dgn-file apo DWG-file me sipërfaqet ndërmjet linjave të bashkimit me informacion në lidhje me numrin e imazhit, numrit të itinerarit të imazheve të skanuara të fotografimit ajrori vitit, ID e projektit, emri i projektit dhe emri i kompanisë që ka prodhuar Ortofoton.
5.4	Ortofoto nuk duhet të përmbajë asnjë piksel me vlerë (0,0,0) në zonën e projektit që janë të mbuluar nga imazhet. Pikseli jashtë zonës duhet të ketë vlerën e (0,0,0).
5.5	Ortofotot duhet të dorëzohen si TIFF dhe JPEG-formatme piramida.

5.6	World file (tfw-file) duhen me të njëjtin emërtim siortofoto.
5.7	Saktësia në plan (devijimi Standart) e ortofotos i prodhuar nga fotografimi historik duhet të jetë: Për GSD 1.5m, devijimi standart duhet te jetë $\pm 7.5m$.
5.8	Cilësia e ortofotos do të përcaktohet se sa mirë janë linjat e bashkimit për mozaikimin e imazheve ajrore, diferenca e kontrastit radiometrik midis imazheve dhe saktësia e pozicionimit.
5.9	Emërtimi i ndarjeve <i>Shënim: Struktura e Indeksimit do të negociohet midis ASIG dhe fituesit të kontratës e cila do të varet nga madhësia e të dhënave dixhitale që do të dorëzohen.</i>

ASIG do të shqyrtojë produktet dhe dokumentacionit për pranim ose refuzim.

Mos-pajtueshmëria me specifikimet e produktit do të kërkojë ripërpunim të plotë ose të pjesshëm në varësi të natyrës së mangësisë.

E njëjta gjë është rasti për mos përputhje me specifikimet e procedurës, nëse nuk mund të dokumentohet se produkti është ende në përputhje me specifikimet e produktit.

4 FJALORI


Saktësia	Saktësia e matjes është, dallimi mes të njësisë së matur dhe vlera e asajnjësie të pranuar si të "vërtetë".
Produkt (artefakt)	Një vëzhgim, efekt, ose rezultati, i pasaktë veçanërisht një rezultat nganjë sistem teknik të veçantë, mbledhje ose të përpunimit.
Kalibrimi	Procesi i identifikimit dhe korigjimit të gabimeve sistematike në hardware, software, ose procedurave. Përcaktimi i gabimeve sistematike në një pajisje matëse duke krahasuar matjet e saj me shenjatapo matjet e një pajisje që konsiderohet e saktë. Sensorë ajrore mund të kalibrohen me anen gjeometrik dhe radiometrike.
Pike kontrolli GCP	Pika të matura për tu përdorur për të vlerësuar saktësinë pozicionale bazës të dhënave gjeohapsinore kundrejt një burim të pavarur i saktësisë më të madhe.
Referenca Gjeodezike (Datum)	Një grup i pikave të referencës në sipërfaqen e Tokës kundrejt të cilave janë bërë matjet për pozicionin. Shpesh duke përfshirë edhe një model të lidhur me formën e Tokës (ellipsoidi referues) të përcaktojë një Sistem koordinativ Gjeografike. Datums vertikale përcakton referencën e lartësisë për sipërfaqen për lartësi dhe thellësi.

Esri ASCII rrjet	Një format raster skedar GIS zhvilluar nga ESRI. Thjeshtë dhe e lehtë për të lexuar dhe shkruar, prandaj përdoret shpesh si një "emërues më i ulët i përbashkët "format këmbimi".
Shape file	Një format vektor për të dhënat Gjeohapsinore për një system software të informacionit gjeografik, përcaktuar dhe zhvilluar nga ESRI.
Drejtimi i fluturimit	Një kalim i vetëm i avionit mbi zonën e caktuar.
GNSS/INS data	GNSS: Global Navigation Satellite System INS: Inertial Navigation System. Të dhënat nga njësi GNSS dhe matjes fillestare që përshkruajnë pozicionin dhe orientimin e sensorëve ajrore në një kohë të caktuar. Këto të dhëna përshkruajnë trajektoret e sensorit.
Rrjet	Një grup të dhënave të rregulluar sistematikisht (p.sh. vlerat e lartësisë) gjeografikisht përfaqësojnë qelizat e masës konstante në të dydrejtimit drejt lindjes dhe Veriut.
Intesiteti	Sasia e dritës të kthyer nga toka.
Shpërndarja isotropike	Shpërndarja uniforme në të gjitha orientimet.
metadata	Metadata përshkruan të dhënat (të dhëna rreth të dhënave). Të dy të dhënat e gjeneruara automatikisht, p.sh. skedarët hyrese dhe të dhënatë krijuara manualisht p.sh përshkrimet tekstuale, janë metadata.
Mbivendosje e zonave	Çdo pjesë e një brezi që po ashtu është i mbuluar nga një pjesë e çdobrezi tjetër.
Precision	Saktësia e një sistemi të matjes shpreh riprodhueshmerine e matjeve.
Projeksion	Një transformim sistematik gjeometrike nga një sistem koordinativ gjeodezike 3 Dimensional të Tokës, në një sistem koordinativ 2D hartë ose plan.
RGB imazh	Një imazh i rregullt dixhital që përbëhet nga tre grupe të Kuq, Jeshile dhe Blu.
RMS	Root do të thotë katror. Vlera statistikore për vlerësimin e precizionit dhe saktësisë.
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor.
Brez	Të dhënat që rezultojnë nga një vijë të vetme të fluturimit.
Trajektore	Rruga që skaneri/avioni përshkron.

1 ANEKSE

Aneksi 1

Harta e zonës së mbulimit fotografimit ajror historik përdorur për prodhimin e H.Topografike Shk. 1:25000. Shkalla e fotografive 1:33000. Viti i fotografimit 1970 deri 1986, dimensionet e fotografive 30cm x 30cm.



Inspektimet, testimet dhe marrja në dorëzim

Inspektimet dhe testimet para pranimit të produktit do të organizohen nga grupi i punës i përcaktuar nga Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG). Marrja në dorëzim e produktit do të realizohet nga grupi i punës i cili do të hartojë procesverbalin e pranimit të produktit brenda 30 ditëve pas dorëzimit të produktit.

Produkti do të pranohet nëse janë realizuar të gjitha kërkesat e përfshira në dokumentat e tenderit dhe termat e referencës.

Prona intelektuale

Ortofoto e prodhuar nga fotografitë ajrore historike është pronë e Shtetit Shqiptar.

Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) gëzon të drejtat e plota të autorit mbi të gjithë produktin e përfutur nga ky projekt.

Raportet

Raportet finale, të cilat do dorëzohen në përfundim të projektit, janë përcaktuar në secilin kapitull në dokumentin e Termave të referencës.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Prodhim i ortofotove nga fotografitë ajrore historike”.

PRODHIM I ORTOFOTOS NGA FOTOGRAFITË AJRORE HISTORIKE			
Nr.	Zërat e shërbimeve	Njësia	Sasia
1	Orientimi i imazheve të skanuara, Aerofototriangulacioni.	Imazhe	7,287
2	Ortorektifikimi i imazheve të orientuara, Prodhimi i ortofotos.	Imazhe	7,287
3	Dorëzimi i Ortofotos në formatet TIF dhe JPEG në 2 kopje dixhitale – Hard Disk (HDD).	HDD	2
4	Hartimi i raportit përfundimtar.	Copë	1

Afatet e ekzekutimit: 75 (shtatëdhjetë e pesë) **ditë** nga nënshkrimi i kontratës

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: **“Prodhim i ortofotove nga fotografitë ajrore historike”.**

Detyrat: Kryerja e shërbimit korrektësi dhe konform specifikimeve të kërkuara

Shpërndarja: sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: *Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG),
Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010 Tiranë, Shqipëri.*

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënua ose nuk ka qenë i dënua nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë: Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, të përcaktuara në pikën 1, Shtojca 9 të DST.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2022-2023-2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20 % e vlerës së fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

-
- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të të dëshmojë dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë:

- SSH EN ISO 9001:2015 (për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë), ose ekuivalente/të barazvlefshme.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë licencë Profesionale të vlefshme, si më poshtë:

- Licencë – Kategoria-8, pikat d) Bazamente gjeodezike, e) projektim fotogrametrik dhe hartografik.

2.3.4 Ofertuesi duhet të përgatisë dhe të dorëzojë një dokument "Ofertë teknike" me kërkesat e listuara si më poshtë:

- Ofertuesi duhet të përgatisë dhe të paraqesë ofertën teknike - një dokument, ku duhet të përshkruajë dhe të dokumentojë se si do të plotësohen kërkesat e detajuara në Termat e Referencës (ky dokument).
- Një përshkrim i detajuar i softeve apo softit që do të përdoret për Aerofototriangulacionin dhe për prodhimin e Ortofotos.
- Ofertuesi duhet të paraqesë një Plan "Produkt i Cilësisë". Ky plan do të përshkruajë se si ofertuesi garanton përmbushjen e kërkesave teknike të projektit.

2.3.5 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, duhet të kenë të punësuar minimumi **4 (katër)** punonjës, si më poshtë:

- 1 (një) Ekspert në fushën e projektimit fotogrametrik dhe hartografik
- 1 (një) Ekspert për ndërtimin e bazamenteve gjeodezike
- 1 (një) Ekspert administrim harduere & softuare dhe rrjetesh kompjuterike
- 1 (një) punonjës ndihmës projektsh

Për punonjësit e kërkuar me lart, duhet të paraqiten dokumentat:

- a. Për Ekspert në fushën e projektimit fotogrametrik;
dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Inxhinier Gjeodezi/ Inxhinier Gjeofizikë/ Inxhinier Gjeomatikë (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), CV përkatëse;

- b. Për Ekspert për ndërtimin e bazamenteve gjeodezike;

dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Inxhinier Gjeodet/ Inxhinier Gjeomatikë/ Inxhinier Gjeoinformatikë (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), CV përkatëse;

c. Për Ekspert administrim harduere & softuare dhe rrjetesh kompjuterike:

dhe për këtë punonjës duhet të paraqitet:

Diplomë me profil Teknologji Informacioni/ Informatike (ose ekuivalente për ekspertë të huaj),

- Kontratë pune (e vlefshme), CV përkatëse;

d. Për punonjësin ndihmës projektesh

- -Kontratë pune përkatëse, (e vlefshme) , diplomë në shkenca kompjuterike ose ekuivalente

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë që stafi i deklaruar për përmbushjen e shërbimeve të jetë i disponueshëm gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të paraqesë të paktën 1 (një) licencë software për përpunimin e fotove ajrore, ku të jenë të përfshira funksionalitetet për zbatimin e objektit të prokurimit, të vlefshme deri në fund të periudhës së shërbimit, si dhe një person të trajnuar për përdorimin e këtij software. Zotërimi i licencës së software të jetë i vërtetuar me dokumentat përkatëse nga prodhuesi i software ose distributori i autorizuar.

Për personin e trajnuar sipas pikës 2.3.7 të paraqitet dokumentacioni provues për trajnimin e lëshuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar.

Kërkesa për një person të trajnuar për përdorimin e software konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Deklarata provuese e kërkuar më sipër, do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë se do të realizojnë shërbimin sipas kërkesave dhe specifikimeve të kërkuara përkatësisht nga Autoriteti Kontraktor ASIG.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

